



Lindita Haxhimehmeti
Drejtoresh
Radio Mitrovica
R008
Sheshi Jasharaj
Mitrovicë

VENDIM:LIC/KPM-2013/15
Ref:1302/375/KPM/ni

VENDIM

lidhur me ndryshimin e lokacionit të transmetuesit të Radio Mitrovicës

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Mitrovica është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale me mbulim lokal, e cila është e licencuar për të transmetuar radio programe në komunën e Mitrovicës. Radio Mitrovica është pajisur nga KPM, me licencë afatgjatë të transmetimit, me datën 6 tetor 2009.
3. Me datën 25 nëntor 2012, Radio Mitrovica përmes një e-maili ka bërë një kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit, nga pika e transmetimit në qytetin e Mitrovicës në piken e transmetimit në Cernush.
4. KPM, përmes një e-mail, me datën 26 nëntor 2012 e ka njoftuar Radio Mitrovicën lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave dhe njëherit ka kërkuar nga ky subjekt transmetues që të mos ndryshojë vendndodhjen e transmetuesit pa miratim paraprak të KPM-së.
5. Për të vlerësuar pajtueshmërinë me Kushtet dhe Termet Teknike të Licencës, Inxhinierët e Divizionit të Menaxhimit të Frekuencave të KPM-së kanë dalë në terren dhe kanë vizituar qytetin e Mitrovicës, me të cilin rast kanë bërë matjet e nevojshme teknike. Përmes, këtyre matjeve është vërtetuar se ky radio stacion nuk është duke transmetuar nga pika e transmetimit në qytet për ku është i licencuar nga KPM,

mirëpo ka vendosur antenat e transmetimit në piken e transmetimit në Cernush, në shtyllën e transmetimit të TV Mitrovicës.

6. Me datën 30 janar 2013, KPM i ka dërguar letër Radio Mitrovicës, përmes të cilës ka kërkuar që brenda 5 ditëve të ofroj sqarime rreth arsyeve të ndryshimit të lokacionit të transmetimit.
7. Me datën 30 janar 2013, Radio Mitrovica ka njoftuar KPM-në se arsyet e ndryshimit të lokacionit të transmetimit ka qene revolta e banorëve të ndërtesës ku ka qenë e vendosur, antena e Radio Mitrovicës, për shkak të rrezatimit, të cilët kanë kërkuar që kjo antenë të largohet nga ai lokacion, duke e detyruar këtë Radio Stacion që ta ndërpres edhe transmetimin.
8. Në bazë të vlerësimit të Inxhinierëve të Departamentit të Menaxhimit të Frekuencave(DMF), ndryshimi i lokacionit të transmetimit i Radio Mitrovicës për të kaluar nga pika e transmetimit ne Mitrovicë në piken e transmetimit në Cernush dhe transmetimi nga kjo pikë, nuk do të shkaktoj ndërhyrje në frekuencat e subjekteve tjera transmetuese.

Arsyetimi

9. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM, është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
10. Neni 6.1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *Përveç dispozitave për transferimin e pronësisë të specifikuar në Nenin 5.0, i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshimet e specifikuara në paragrafët e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Përhapjes Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit, duke ia bërë me shkrim kërkesën për këto ndryshime KPM-së. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm me miratim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së.*
11. Neni 6.1 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë shumë të nevojshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit të frekuencës dhe i Licencuari kishte një mundësi të arsyeshme që të bënte paraqitjen para KPM-së për sa i përket ndryshimeve të propozuara.*
12. Arsyetimin për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit nga ana e parashtruesit të kërkesës, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në shërbim të interesit publik për të aprovuar kërkesën për këtë ndryshim.


Vendim

13. Komisioni i Pavarur për Media, vlerëson se ndryshimi i lokacionit të transmetuesit të Radio Mitrovicës, nuk do të ndikojë në ndryshimin e formatit të programit.

14. Komisioni i Pavarur për Media, vendos që lokacioni i transmetuesit i Radio Mitrovicës të ndryshohet sipas kërkesës, duke kaluar nga lokacioni i transmetuesit në Mitrovicë në lokacionin e ri në Cernushë.

Lëshimi i Vendimit

15. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media.



Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media

15.02.2013
datë